

Instituti për Studime të Avancuara GAP

Letërnjoftimi i Komunës së Suharekës 2013

Mars, 2013

“Letërnjoftimi i Komunave” është projekt i Institutit GAP i cili vlerëson qeverisjen komunale tri vite pas zgjedhjeve lokale të 2009. Ky projekt është implementuar në bashkëpunim me Rrjetin Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN) dhe Qendrën e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim (ATRC). Rezultatet e hulumtimeve të GAP për qeverisjen komunale janë debatuar me kryetarët e komunave në emisionet “Jeta në Kosovë”.

Përmbajtja

Përmbledhje ekzekutive	3
1. Hyrje	4
2. Problemet në Komunën e Suharekës.....	6
3. Performanca buxhetore e Komunës së Suharekës	7
4. Investimet kapitale	10
5. Aktivitetet e Prokurimit Publik.....	13
6. Administrata e Komunës së Suharekës.....	15
7. Arsimi në Komunën e Suharekës.....	16
8. Transparenca	17
9. Përmbushja e premtimeve të fushatës zgjedhore 2009	19
10. Burimet	23

Përmbledhje ekzekutive

Pas nëntë viteve të qeverisjes nga ana e LDK, Suhareka në zgjedhjet lokale të 2009 për kryetar komune votoi kandidatin e AAK z.Blerim Kuçi, një ish anëtar dhe ish ministër nga radhët e LDK. Blerim Kuçi arriti të fitoi shumicën e votave në raundin e dytë zgjedhor për kryetar komune, edhe pse partia e tij u radhit e treta me vota në garën për Kuvendin Komunal.

Kryetari i Komunës së bashku me zëvendësin e tij, kanë ofruar shembull të mirë duke hequr dorë nga marrja e pagës mujore në ushtrimin e pozitës së Kryetarit, përkatësisht nënkryetarit, dhe pagat e tyre rregullisht transferohen në kontot e nxënësve dhe studentëve të dalluar të kësaj Komune. Kryetari ka hequr dorë nga paga, por jo edhe nga kompania private të cilën e përfaqëson dhe menaxhon duke deklaruar 100% aksione, ndonëse kjo bije ndesh me Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

Komuna e Suharekës ka përmbyllur vitin 2012 duke prezantuar mbi 2.9 milionë euro të hyra komunale, të cilat shikuar nga viti paraprak (2011), janë për rreth 1.3 milionë euro më shumë. Por, kjo rritje ka ardhur nga aplikimi i taksës mbi shpronësimin e tokave në trasenë e autostradës "Ibrahim Rugova". Këto të hyra nuk do të mund të figurojnë edhe në vitet në vazhdim, çka do të bëjnë Komunën e Suharekës të llogaritet më rënie drastike të të hyrave komunale.

Të dhënat zyrtare tregojnë se gjatë tri viteve të fundit, Zyra e Kryetarit të Suharekës, krahasuar me komunat e tjera, ka pasur shpenzime me shifra të arsyeshme, por kjo nuk mund të thuhet edhe për dikasteret e tjerë komunale në Suharekë. Kësisoj, vetëm gjatë vitit 2012, Komuna e Suharekës ka shpenzuar për dreka dhe darka mbi 42.000 euro, ndërsa shikuar nga fillimi i mandatit (2010-2012), për dreka dhe darka, Komuna e Suharekës ka shpenzuar mbi 92.000 euro, në telefon mobil mbi 79.000, ndërsa në telefon fiks mbi 71.000 euro. Edhe në raportet financiare për vitin 2011 dhe atë 2012, Komuna e Suharekës nuk ofron pasqyra të detajuara të shpenzimeve, gjë që e bën të pamundur saktësimin e shpenzimeve në disa kategori. Askund në këto raporte nuk tregohen shumatat e shpenzuara për derivate për automjete, apo derivate për gjenerator, naftë për ngrohje, apo blerje e druve dhe thëngjillit. Të gjitha këto janë futur në një linjë duke u emërtuar si "shpenzime për lëndë djegëse". Gjatë tri viteve (2010-2012) për lëndë djegëse janë shpenzuar afro 850.000 euro.

Nga gjithsej 194 persona të punësuar në administratën komunale, vetëm 32 të punësuar apo 16% janë femra. Nga nëntë drejtori sa ka Komuna e Suharekës, asnjë prej tyre nuk udhëhiqet nga femrat.

Komuna e Suharekës është njëra ndër komunat ku më së paku gjenden të dhëna, informata dhe dokumente në faqen e saj zyrtare. Në këtë faqe nuk mund të gjejmë asnjë raport për buxhetin apo për mënyrën dhe fushat e shpenzimit të parasë publike.

Në këtë raport, i cili mbulon zhvillimet rreth politikave publike në komunën e Suharekës për periudhën janar 2010 – dhjetor 2012, Instituti GAP ka përmendur problemet më të mëdha me të cilat përballen qytetarët, ka analizuar performancën buxhetore, investimet kapitale, aktivitetet e prokurimit publik, gjendjen në administratë dhe arsim, transparencën e Komunës, si dhe ka matur realizueshmërinë e premtimeve të dhëna gjatë fushatës zgjedhore të 2009.

1. Hyrje

Komuna e Suharekës udhëhiqet nga Kryetari Blerim Kuçi. Ai e ka fituar këtë pozitë duke përfaqësuar subjektin politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK). Blerim Kuçi ka hyrë në vitin e fundit të mandatit të parë si Kryetar Komune. Në zgjedhjet lokale të 2009, Blerim Kuçi ka fituar garën për kryetar komune vetëm pas raundit të dytë të zgjedhjeve. Në raundin e parë fitoj 34% të votave, kundruall kundër kandidatit të tij nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK) Ramë Vata me 32.5% të votave.¹ Në balotazh, i cili është organizuar me 21 janar 2010, Kuçi morri 52.4% të votave, ndërsa Vata 47.6%. Blerim kuçi konsiderohet si figura kyçe e cila ka arritur që të kthej partinë e tij si fituese në garën për kryetar komune. AAK është e treta për nga fuqia e votave dhe numri i ulëseve në Kuvendin Komunal.

Një vit e gjysmë pas marrjes së mandatit, Kryetari i Komunës u arrestua dhe u dënua me një muaj burgim nga Prokuroria Speciale e EULEX-it, për mos bashkëpunim me organet e drejtësisë në rastin “Kleçka” (gjyqi ndaj Fatmir Limajt). Pas vuajtjes së dënimit, Kuçi i është kthyer pozitës së Kryetarit të Komunës.

Ekzekutivi i Komunës së Suharekës përbehet nga nëntë drejtori. Asnjë Drejtori nuk udhëhiqet nga femrat. Përkundër asaj se AAK nuk e ka shumicën e votave në Kuvend, kjo parti nuk ka lidhur formalisht koalicion me asnjë parti tjetër. Rezultatet e zgjedhjeve për anëtar të Kuvendit Komunal të Suharekës, kanë nxjerrë LDK si partinë me numrin më të madh të ulëseve në KK (11 ulëse), pas saj vie PDK dhe AAK (secila me nga 10 ulëse), LDD me dy ulëse dhe nga një ulëse kanë fituar AKR dhe Partia Socialiste e Kosovës (PSK).² Pas zgjedhjeve, ka pasur lëvizje të kandidatëve në mes partive, ku tani AAK ka 12 ulëse, LDK 12, PDK 8, AKR 1, PS 1 dhe një kandidat i pavarur.³

Menjëherë pas emërimit të drejtorëve të Drejtorive, Kryetari i Komunës Blerim Kuçi, ka emëruar politikisht edhe tre këshilltarë për resorët si: Këshilltar për Mbrojtje dhe Siguri, Këshilltar për Ekonomi dhe Këshilltar për Shëndetësi. Të gjithë këta janë paguar nga ana e buxhetit komunal, deri sa në korrik të 2012, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) ka nxjerr një shkresë ligjore ku emërimet e këtyre këshilltareve i ka

¹ Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Rezultatet e zgjedhjeve për Kryetar të Komunave. 2009. Fq 25. Burimi: <http://www.kqz-ks.org/SKQZ-WEB/al/zgjedhjetekosoves/materiale/rezultatet2009/kryetar/results%20by%20municipality%20.pdf>

² KQZ. Rezultatet e Komunave – Ndarja e Vendeve. Burimi: <http://www.kqz-ks.org/SKQZ-WEB/al/zgjedhjetekosoves/materiale/rezultatet2009/komune/ResultsByMunicipality.pdf>

³ Komuna e Suharekës. Përbërja e Kuvendit Komunal. Burimi: <http://kk.rks.gov.net/suhareke/Municipality/Assembly/Stafi-i-Asamblese-Komunale.aspx>

cilësuar pa bazë ligjore dhe në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisje lokale.⁴

Në regjistrimin e fundit të popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave, Suhareka rezulton të ketë 59.722 banorë.⁵ Për nga numri i banorëve kjo komunë është e përafërt me Komunën e Drenasit, Lipjanit dhe Rahovecit.⁶ Para regjistrimit të popullsisë, Suhareka vlerësohej të ketë rreth 80.000 banorë (sipas Ministrisë së Financave), apo edhe 90.000 banorë (sipas një profili të publikuar nga Komuna e Suharekës⁷). Ministria e Financave në ndarjen e granteve për komuna ende e përlogarit Suharekën si komunë me 80.000 banorë. Sipas Ministrisë së Financave, nga viti i ardhshëm, grantet e komunave do të rishikohen në bazë të të dhënave të reja nga regjistrimi i popullsisë. Kësisoj, Komuna e Suharekës rrezikon që të ketë 131.000 euro më pak të hyra nga granti qeveritar.⁸

Komuna e Suharekës, njëjtë si Komuna e Drenasit, zyrtarisht mban tjetër emër, kurse me tjetër emërtimin i referohet praktikisht. Kësisoj, te rasti i Suharekës, dokumentacioni lëshohet me emërtimin Suharekë, ndërsa në përditshmëri përdoret emërtimi Therandë. Në fund të vitit 2012, Kryetari i Komunës ka formuar një grup punues i autorizuar për t'i përpiluar arsyet e ndërrimit të emërtimit të Komunës, të cilat planifikohet t'i dërgohen Kuvendit të Kosovës për ndërrimin e emërtimit të Komunës nga ajo ekzistuesja (Suharekë) në atë që pretendohet (Therandë). Pas formimit të këtij komisioni, kryetari i Komunës së Suharekës ju ka drejtuar me një kërkesë Ministrisë së Administrimit të Pushtetit lokal (MAPL) ku ka kërkuar shpjegime në lidhje me iniciativën e tij. Në përgjigjen e MAPL, hapi i Komunës së Suharekës është vlerësuar i pa bazë, ngase Komunitat nuk kanë të drejtë ligjore t'i ndërrojnë emrat e fshatrave dhe Komunës, përjashtimisht rrugëve dhe lagjeve.⁹

⁴ Ministria e Administrimit të Pushtetit lokal. Udhëzues ligjor, 0201-538/1. Datë 17.07.2012. Burimi: <http://mapl.rks-gov.net/getattachment/bf22fb27-6952-4410-b1f9-2315375b7c6b/Shkrese-Ligjore-0201-538-1-2012.aspx>

⁵ Agjencia e Statistikave të Kosovës. Rezultatet përfundimtare për Regjistrimin e Popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave - 2011. Burimi: http://esk.rks-gov.net/rekos2011/repository/docs/Te%20dhenat%20kryesore_ALB.pdf

⁶ Nga regjistrimi i popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave. Drenasi ka rezultuar t'i ketë 58.531 banorë. Lipjani 57.605 banorë. Rahoveci 56.208 banorë. Burimi: http://esk.rks-gov.net/rekos2011/repository/docs/Te%20dhenat%20kryesore_ALB.pdf

⁷ Komuna e Suharekës. Profili i Suharekës. Fq 2. Burimi: <http://kk.rks-gov.net/suhareke/getattachment/Home/Profili-i-Komunes.pdf.aspx>

⁸ Instituti për Studime të Avancuara GAP. Të dhënat e Regjistrimit të Popullsisë dhe ndikimi i tyre në Politikën Publike. Burimi:

http://www.institutigap.org/documents/67092_GAPanalizepertedhenateASK.pdf

⁹ Ministria e Administrimit të Pushtetit lokal. Udhëzues ligjor, 0201/12/1. Datë 25.01.2013. Burimi: <http://mapl.rks-gov.net/getattachment/0ae70526-0c6e-4e90-8f15-4389f23bc996/Pergjigje-ne-Kerkese---Konsultim-Paraprak-KK-Suh.aspx>

2. Problemet në Komunën e Suharekës

Edhe përkundër përpjekjeve të autoriteteve lokale për zgjidhjen e problemeve më të cilat përballen qytetarët e Suharekës, akoma shumë zona të kësaj Komune përballen me mungesë ujësjellësi dhe kanalizimesh, rrugë të pashtuara, në disa zona objektet shkollore janë të vjetruara dhe nuk i plotësojnë kushtet e nevojshme për mësim. Lumi i qytetit në pjesën më të madhe të tij është i parregulluar dhe njëherazi dukuria e prerjes ilegale të pyjeve ka vazhduar edhe përkundër marrjes së masave në parandalimin e kësaj dukurie.

Investimet në objektet arsimore të kësaj komune kanë qenë të kënaqshme në tri vitet e fundit. Shkalla e investime të realizuara nuk ka mundur zgjidhjen e problemeve infrastrukturore shkollore. Kësisoj, në gjendje më të vështirë është shkolla fillore në fshatin Duhël dhe objekti i shkollës në fshatin Leshan i cili është i ndërtuar që nga viti 1946, ku në të zhvillojnë mësimin 480 nxënës. Edhe shkolla në fshatin Nishor është në jo të mirë. Në vitin 2010, MAPL kishte shpallur tender për ndërtimin e tri shkollave në këto tri fshatra, mirëpo tenderi ishte anuluar menjëherë pas zgjedhjeve të përgjithshme të 2010. Gjendje jo e mirë e objekteve shkollore ka ekzistuar edhe në fshatrat Mohlan dhe Gjinoc, mirëpo në këto dy fshatra janë ndërtuar objektet shkollore me ndihmën e donacioneve nga Austria dhe MAPL. Probleme me infrastrukturën e shkollave është hasur edhe në ato objekte ku ka pasur investime të konsiderueshme në riparimin e tyre. Në këtë gjendje është shkolla në fshatin Bllacë, ku pas një periudhe të shkurtër të përfundimit të punimeve në riparimin e shkollës, ka nisur lëshimi i ujit të shiut nga kulmi duke shtyrë autoritetet e shkollës të ndërpresin mësimin për disa ditë.

Banorët e fshatit Lumbardhë ankohen që autoritetet komunale i kanë anashkaluar nga investimet publike. Në gjysmën e dytë të vitit 2012, banorët e këtij fshati u janë drejtuar me një kërkesë Komunës së Suharekës duke i akuzuar ata për anashkalim të qëllimshëm dhe duke kërkuar njëkohësisht investime në fshat, si në infrastrukturën rrugore, në kanalizim, ujësjellës dhe në ndërtimin e shkollës së re.

Probleme me mungesën e infrastrukturës nuk kanë vetëm banorët e fshatit Lumbardhë. Me mungesë ujësjellësi dhe kanalizimi përballen pjesa dërrmuese e zonave të Suharekës. Problemet më të theksuara janë nëpër fshatrat e kësaj ane, veçmas në fshatin Gelanc, Leshan, Gjinoc, Dubravë, Nishor dhe Duhël. Pa infrastrukturë të nevojshme gjendet edhe zona e Reçanit, e cila nga qendra e qytetit ka distancë 5 kilometra. Përveç problemeve nga mungesa e rrjetit të ujësjellësit, Suhareka vazhdon të përballlet me reduktime të shpeshta të ujit të pijes në pothuajse të gjitha zonat e qytetit, veçmas gjatë sezonit të verës.

Një problem tjetër i cili në vazhdimësi ka përcjellë Komunën e Suharekës, është pamundësia e autoriteteve të kësaj ane për të zgjidhur problemin e derdhjes së kanalizimeve në lumin e qytetit Toplluha. Me dhjetëra zona të qytetit dhe fshatrave


përreth, derdhjen e kanalizimeve e kanë të orientuar në shtratin dhe rrjedhën e lumit, duke shkaktuar kështu ndotje.

3. Performanca buxhetore e Komunës së Suharekës

Komuna e Suharekës ka përfituar afro 1.3 milionë euro nga taksa për shpronësimet e tokave në trasenë e autostradës "Ibrahim Rugova". Këto përfitime janë kategorizuar si të hyra komunale dhe kështu ka rezultuar me rritjen enorme të hyrash komunale. Gjatë vitit 2011, Komuna e Suharekës nuk ka pasur asnjë të nga taksa për shpronësim tokash, ndërsa gjatë vitit 2012 kjo kategori e të hyrave ishte afro 1.3 milionë euro.

Krahasimi i të hyrave komunale mes vitit 2011 dhe 2012, rezulton se në shumicën e linjave buxhetore ka pasur rënie të hyrash, si në tatimin në pronë, nga taksa për regjistrimin e bizneseve, nga regjistrimi i automjeteve, nga qiraja në objektet publike. Ndërsa rritje të hyrash ka pasur në kategorinë nga taksa për leje ndërtimi si dhe nga sfera e arsimit dhe shëndetësisë.¹⁰

Grafikoni nr.1: Të hyrat komunale në Suharekë gjatë katër viteve të fundit



Në rast se nuk do të merreshin parasysh të hyrat nga shpronësimi i pronave në trasenë e autostradës, të hyrat vetanake në 2012 do të ishin pothuajse të njëjta sikurse ato të 2011 (në grafikonin nr.1, vija dhe shuma me të kuqe paraqesin skenarin e të hyrave në rast se nuk do të ekzistonin të hyrat e shpronësimeve). Të hyrat e vitit të 2013, sipas Buxhetit të Komunës së Suharekës për 2013, pritet të jenë 1.7 milion euro, pak më shumë se të hyrat e 2011.

¹⁰ Komuna e Suharekës. Drejtoria për Financa dhe Zhvillim Ekonomik. Raporti financiar i Komunës së Suharekës për vitin 2012. Fq 14.

Tabela nr.1: Pasqyrimi i të hyrave komunale gjatë vitit 2012 sipas sektorëve dhe krahasimi i tyre me vitin 2011

Linja e të hyrave	Shuma (euro)		
	2012	2011	Diferenca
Tatimi në pronë	554.000	606.000	-52.000
Taksa për leje ndërtimi	206.000	76.000	+130.000
Taksa për regjistrimin e biznesit	232.000	264.000	-32.000
Taksa për regjistrimin e automjeteve	91.000	97.000	-6.000
Të hyra - taksa nga shpronësimi i trasesë në autostradë	1.269.000	00	+1.269.000
Taksë nga certifikata e lindjes	24.000	22.000	+2.000
Taksë për regjistrimin e trashëgimisë	13.000	12.000	+1.000
Taksë nga certifikata e kurorëzimit	8.000	7.000	+1.000
Taksa tjera nga shërbimet e ofiqarisë	51.000	55.000	-4.000
Taksë për vërtetimin e dokumenteve	12.000	6.000	+6.000
Të hyrat nga taksat tjera	4.000	7.000	-3.000
Të hyra për marrjen e dokumenteve shëndetësore	6.000	3.000	+3.000
Tarifa për pjesëmarrje në tender	8.000	15.000	-7.000
Taksa për licencim	00	2.000	-2.000
Taksë nga qiraja për objektet publike	77.000	83.000	-6.000
Të hyra nga shitja e pasurisë	2.000	7.000	-5.000
Taksa për shfrytëzimin e pronës publike	61.000	61.000	00
Të hyra nga shëndetësia dhe arsimit	122.000	76.000	+46.000
Të hyra nga pëlqimi sanitar	13.000	14.000	-1.000
Të hyra nga kadastra	73.000	73.000	00
Të hyrat nga gjobat në trafik	42.000	97.000	-55.000
Të hyrat nga gjobat e gjykatave	38.000	52.000	-14.000
Totali	2.906.000	1.635.000	+1.271.000

Gjatë një viti, Komuna e Suharekës ka në dispozicion mbi 12 milionë euro buxhet. Pjesa më e madhe e buxhetit shpenzohet për paga dhe mëditje të stafit të angazhuar në administratë komunale, arsim dhe shëndetësi. Pas pagave, investimet kapitale përbëjnë kategorinë më të madhe shpenzuese buxhetore. Në dy vitet e fundit vërehen një rënie e lehtë e buxhetit total të Komunës së Suharekës, siç mund të shihet edhe nga tabela nr.2.

Tabela nr.2: Buxheti i përgjithshëm i Komunës së Suharekës në tri vite

Kategoria	2013	2012	2011
Investime Kapitale	4.960.122	5.035.118	5.191.015
Mallra dhe shërbime	821.468	831.468	897.959
Subvencion dhe transfere	163.000	130.000	129.291
Shpenzime komunale	237.000	227.000	201.392
Paga	6.100.000	6.064.898	5.935.181
Totali	12.281.590	12.288.484	12.354.838

Niveli i shpenzimeve në disa kategori brenda linjës së shpenzimeve për mallra dhe shërbimeve, nuk rezulton të jetë i vogël. Krahasimi mes viteve tregon për rritjen e shpenzimeve në dreka dhe darka zyrtare, në telefon si dhe në shfrytëzimin e karburanteve. Komuna e Suharekës brenda një viti në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve ka në dispozicion mbi 821.000 euro.

Tabela nr.3: Shpenzimet në disa kategori në linjën për mallra dhe shërbime në Komunën e Suharekës sipas Drejtorive dhe sektorëve - 2011

Sektorët	Dreka zyrtare	Telefoni mobile	Udhëtime
Zyra e Kryetarit	7.447	630	3.929
Administrata	1.470	4.660	10.640
Buxhet dhe Financa	1.770	1.560	3.540
Kulturë, Rini dhe Sport	1.203	1.810	2.414
Urbanizëm	2.491	1.780	2.905
Inspektion	1.057	690	721
Shërbime Publike	1.454	2.140	735
Zyra e Kuvendit	3.341	1.813	2.210
Bujqësia	1.375	2.010	3.600
Zyra për Komunitete	00	00	00
Shëndetësia	1.565	3.248	4.085
Arsimi	5.553	4.519	6.496
Totali	28.726	24.860	41.275

Komuna e Suharekës edhe në raportet financiare për vitin 2011 dhe 2012, nuk ofron pasqyra të detajuara të shpenzimeve, me përjashtim të shpenzimeve të përgjithshme në pjesën dërmuese të kategorive. Kjo e bënë të pamundur saktësimin e shpenzimeve në disa kategori. Kësisoj, Komuna e Suharekës i ka të grumbulluara në raportin e saj financiar disa shpenzime në një linjë. Askund në këto raporte nuk tregohen shumat e shpenzuara për derivate për automjete, apo derivate për gjenerator, naftë për ngrohje, apo blerje e druve dhe thëngjillit. Gjitha këto janë futur në një linjë duke u emërtuar si "shpenzime për lënde djegëse". Kjo formë e raportimit krijon paqartësi për nivelin e shpenzimeve dhe kategoritë e tyre. Njësoj është vepruar edhe te linja për mirëmbajtje. Përderisa do të duhej të figuronte linja e mirëmbajtjes së veturave, linja e mirëmbajtjes së objekteve, linja për mirëmbajtjen e pajisjeve dhe mobileve, si dhe linja për mirëmbajtjen e rrugëve, Komuna e Suharekës i ka inkorporuar të gjitha këto në një linjë. Këto janë kategorizuar si shpenzime për mirëmbajtje, duke e pamundësuar kësijoj qartësimin se sa mjete janë shpenzuar në atë linjë e sa në linjën tjetër.

Tabela nr.4: Vlerësimi i totalit të shpenzimeve gjatë vitit 2010, 2011 dhe 2012 në disa kategori nga Komuna e Suharekës

Kategoria	2010	2011	2012	Totali
Derivate dhe lëndë djegëse	234.000	286.000	329.000	849.000
Dreka dhe darka zyrtare	22.000	28.000	42.000	92.000
Shpenzimet në telefoni mobile	23.000	32.000	24.000	79.000
Shpenzimet ne telefoni fikse	19.000	29.000	23.000	71.000
Shpenzimet e udhëtimit	27.000	48.000	58.000	133.000
Mirëmbajtje veturash, objektesh, rrugësh	216.000	168.000	172.000	556.000

Rritje të shpenzimeve janë vërejtur edhe në kategorinë e shpenzimeve komunale. Rritje më të madhe ka shënuar kategoria për energji elektrike dhe ka ardhur nga zgjerimi i zonave që mbulohen me ndriçim publik. Në 2010, kjo komunë ka shpenzuar për mbeturina dyfish më shumë se sa në vitet 2011 dhe 2012.

Tabela nr.5: Prezantimi i shpenzimeve në linjën e shpenzimeve komunale për vitin 2010 dhe krahasimi me vitin 2011 dhe 2012

Kategoria	2010	2011	2012
Pagesat për energji elektrike	93.000	128.000	150.000
Pagesat për ujë	31.000	26.000	32.000
Pagesat për mbeturina	58.000	18.000	22.000

4. Investimet kapitale


Investimet kapitale në Komunën e Suharekës gjatë tri viteve të kaluara kanë pasur një shtrirje relativisht të gjerë duke u fokusuar kryesisht në rregullimin e rrugëve që përfshijnë rehabilitimin, asfaltimin dhe pjesërisht ndriçimin e tyre. Investime kapitale ka pasur edhe në zgjerimin e rrjetit të ujësjellësit, por mbeten të pamjaftueshme investimet në rregullimin dhe instalimin e kanalizimeve. Shuma e përgjithshme e mjeteve që ka në dispozicion Komuna e Suharekës gjatë një viti për investime kapitale sillet rreth 5.2 milionë euro.

Tabela nr.6: Pasqyrimi i investimeve më të mëdha të Komunës së Suharekës në linjën e investimeve kapitale gjatë vitit 2010, 2011 dhe 2012

Projektet kryesore të realizuara gjatë 2012	Shuma (euro)
Rregullimi i shtratit të lumit -Bershanc	29.669
Ndërtimi i rrugëve lokale në Sllapuzhan	21.986
Ndërtimi i rrjetit të kanalizimit në fshatin Mohlan	9.995
Ndërtimi i trotuareve në Duhël	31.234.
Ndërtimi i murit mbrojtës në Sallagrazhde	6.091
Ndërtimi i Kroit i Bardhë -lagja e Lugëve në Duhël	27.785
Ndërtimi rrugës në Bukosh	29.328.
Ndërtimi i rrugëve lokale në Vraniq	88.950.
Investime në stadiumin e qytetit	35.9625
Ndërtimi i rrugëve lokale në fshatin Sopijë	9.995
Ndërtimi i rrugëve lokale në fshatin Budakovë	5.258
Ndërtimi i rrugës në fshatin Reqan	37.943
Ndërtimi i rrjetit të kanalizimit në fshatin Kryshicë	27.028
Ndërtimi i rrugëve lokale në Dubravë	11.999
Rregullimi i kanalizimit të lagja e Gegëve - Studenqan	7.524
Ndërtimi i rrugëve lokale në fshatin Terrnje	32.840
Ndërtimi i ujësjellësit në fshatin Stravuqin	14.240
Rregullimi i rrugës Qafa Duhlës - Grejqevc	129.686
Ndërtimi i rrugëve lokale në fshatin Grejkoc - 'Faza e dytë'	24.935
Ndërtimi i rrugëve lokale në fshatin Peqan- 'Faza e dytë'	16.600
Ndërtimi i rrugëve lokale në fshatin Muhlan - Vershec	17.439
Ndërtimi i rrugës Topliqan Gjinoc- 'Faza e parë'	68.239
Ndërtimi rrugës Samadraxhë - magjstralja	115.211
Ndërtimi i rrugës në Maqitevë	210.540
Ndërtimi i rrugës Peqan - Semetisht	39.923
Ndërtimi i rrugës me kubëza betoni në fshatin Leshan	21.985
Ndërtimi i rrjetit të kanalizimit në fshatin Muhlan	25,726,
Ndërtimi i rrugëve lokale në fshatin Mushtisht 'Faza e dytë'	40.210
Projektet kryesore të realizuara gjatë 2011	Shuma (euro)
Ndërtimi i rrugëve lokale në Budakovë 'Faza e dytë'	13.987
Ndërtimi i ujësjellësit në Nishor	53.963
Rregullimi i ujësjellësit në Delloc	9.970
Rregullimi i kanalizimit në fshatin Bllacë	26.992
Ndërtimi i rrugës Dobërdelan- Pagarushë	38.267
Ndërtimi i urës në Smetisht	30.000
Ndërtimi i rrugës Nishor -Kravasari	29.855
Rregullimi i shtratit të lumit Toplluha	232.625
Rregullimi i kanalizimit në Sopijë (dy lagje)	19.861
Ndërtimi i kanalizimit Nishor - Kosterc 'Faza e parë'	116.341
Ndërtimi i kanalizimit në fshatin Bllacë	112.497
Ndërtimi i rrugës, lagja Sopevë, Dragaqin, Grejqevc	181.105

Ndërtimi i disa rrugëve lokale në qendër të qytetit	84.687
Ndërtimi i ujësjellësit në Grejkoc 'Faza e dytë'	103.438
Ndërtimi i rrugës Kryshica e Epërme -Papaz	33.300
Projektet kryesore të realizuara gjatë 2010	Shuma (euro)
Ndërtimi i ujësjellësi në fshatin Grejkoc 'Faza e parë'	50.183
Ndërtimi i rrugës në fshatin Budakovë - lagja e "Hoxhëve"	36.221
Ndërtimi i rrugës në fshatin Kosterc	28.876
Ndërtimi i rrugëve lokale në zonat urbane të qytetit	308.800
Ndërtimi i kanalizimit në fshatin Sllapuzhan	
Ndërtimi i kanalizimit në Shirokë lagja e "Qadrakëve"	19.940
Renovimi i sallës së Kuvendit Komunal	19.651
Ndërtimi i kanalizimit në fshatin Vraniq 'Faza e dytë'	8.900
Ndërtimi i kanalizimit në fshatin Muhlan lagja e "Kabashve"	3.498
Ndërtimi i rrugëve lokale në Samadraxhë	56.316
Ndërtimi i rrugës në fshatin Budakovë - lagja e "Hoxhëve"	113.831
Ndërtimi i rrugës Brigada 123 në Suharekë	174.588
Ndërtimi i rrugës së Çadrakëve - Gelacë	46.340
Ndërtimi i rrugës në fshatin Mushtisht - Baqevc	186,910
Rregullimi i rrugës "Hamdi Berisha" - Suharekë	18.810

Grafikoni nr.2: Shpërndarja e buxhetit për investime kapitale të Komunës së Suharekës për vitin 2013



Burimi: <http://www.institutigap.org/spendings/?suhareke/2013#/~/~suhareke/shpenzimet-kapitale>

Edhe në vitin 2013, buxheti për investime kapitale është mbi 4.9 milion euro. Shuma më e madhe e mjeteve për investime kapitale, apo 51% të buxhetit për investime, do të investohet në rrugë. Pjesa tjetër e investimeve do të orientohet në kategoritë tjera të infrastrukturës, si kanalizime, ujësjellës, trotuare, objekte shkollore, shëndetësi, etj.

5. Aktivitetet e Prokurimit Publik

Fushën e prokurimit publik, Komuna e Suharekës e ka të rregulluar në nivel të zyrës e cila sipas organogramit funksionin brenda Zyrës së Kryetarit. Kjo zyre ka gjithsejtë tre persona të punësuar, ku njëri nga ta mban pozitën e Shefit të Zyrës së Prokurimit. Për tre vite (2010-2012) Komuna e Suharekës ka lidhur 558 kontrata nëpërmjet procedurave të prokurimit publik, me një vlerë të kontratave mbi 15 milionë euro.

Tabela nr.7: Kontratat e Prokurimit në Komunën e Suharekës 2010-2012

Viti	Nr. i kontratave	Vlera e kontratave (euro)
2010	152	3.878.437,80
2011	212	6.275.238,35
2012	194	4.871.944,20
Totali	558	15.025.620,35

Për vitin 2012 të dhënat përfshijnë vetëm njoftimet e KRPP-së

Rastet e shkeljeve të rregullave të prokurimit publik nga ana e autoriteteve të Komunës së Suharekës, janë konstatuar disa herë radhazi edhe nga ana e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP). Gjatë vitit 2012 në OSHP janë adresuar katër ankesa, në dy prej të cilave është konstatuar se Komuna e Suharekës i ka shpërfillur rregullat e prokurimit gjatë procedurave të tenderimit. Ndërsa, në vitin 2010 dhe 2011 në OSHP ankesa për Komunën e Suharekës kanë shkuar gjithsejtë 13, nëntë prej të cilave nga OSHP janë vlerësuar s'i ankesa të bazuara, përkatësisht është konstatuar se Komuna e Suharekës nuk i ka përfillur rregullat e prokurimit publik.¹¹

Komuna e Suharekës nuk rezulton të këtë shpërfillur vetëm rregullat e prokurimit, por edhe vendimet e OSHP-së. Këtë konstatim e ka nxjerr raporti i auditimit të jashtëm për vitin 2011. Përkatësisht, gjatë ndërtimit të "Shtëpisë për Kujdes" për të moshuarit në fshatin Gjinoc në vlerë të punimeve prej 372.390 euro, ka pasur ankesa në dy proceset e mëparshme të tenderimit dhe procesi është dërguar në OSHP. Ky organ ka udhëzuar autoritetin kontraktues për rivlerësimin e ofertuesve dhe kërkoj të merren masa kundër

¹¹ Organi Shqyrtues i Prokurimit. Vendimet e shpallura. Komuna e Suharekës. Viti 2010. 2011. 2012. Burimi: <http://oshp.rks-gov.net/?cid=1,71>

menaxherit të prokurimit për shkak të mungesës së përgjegjesisë dhe saktësisë.¹² Megjithatë, asnjë masë nuk është ndërmarr nga menaxhmenti i komunës ndaj menaxherit të prokurimit.¹³

Përveç kësaj, vlerësimi i dosjeve të tenderëve në Komunën e Suharekës nga ana e Auditorit të Përgjithshëm ka konstatuar se te rasti i ndërtimit të shtratit të lumit Toplluha - faza III, në vlerën e 232.635 eurove, mbikëqyrësi i punimeve ka qenë në të njëjtën kohë anëtar i komisionit vlerësues të tenderëve. Përveç kësaj, në këtë rast komisioni vlerësues zgjodhi dy ofertues, edhe pse njëri nga ofertuesit nuk kishte paraqitur deklaratën tatimore për tremujorin e fundit, ashtu siç kërkohet në dosjen e tenderit. Prandaj, tenderi do të duhej të ri tenderohej për shkak të faktit se ka ekzistuar vetëm një ofertues i përgjegjshëm.¹⁴

Edhe pas zgjedhjes si Kryetar i Komunës së Suharekës, z. Kuçi nuk ka hequr dorë nga përfaqësimi dhe menaxhimi i kompanisë private "Hidroterm". Në formularin e deklaratimit të pasurisë në Agjencinë Kundër Korrupsionit, ka deklaruar pjesëmarrje të 100% të aksioneve në kompaninë "Hidroterm".¹⁵ Kjo bje ndesh me Ligjin për parandalimin e konfliktit të interesit. Në nenin 17 të këtij Ligji thuhet se *të gjithë personat publik që përfaqësojnë pozita të larta politike, nuk mund të kenë më shumë se 20% të aksioneve në kompanitë private*.¹⁶ Kompania të cilën e menaxhon Kryetari Kuçi, ka fituar tender nga ana e Qeverisë së Kosovës në muajin gusht të vitit 2011 në vlerë prej 3.5 milionë eurove për ndërtimin e objektit të Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës.¹⁷ Kjo kompani nuk është hasur të këtë konkurruar apo fituar tender në Komunën e Suharekës në tri vitet e fundit.

Por në vitin 2002, Kompania e Blerim Kuçit kishte përfituar nga një kontratë me Komunën e Suharekës për të ndërtuar disa objekte banesore në qendër të qytetit. Kjo procedurë ishte zhvilluar vetëm me marrëveshje në mes Komunës dhe kompanisë "Hidroterm". Këto ndërtesa në Suharekë njihen si "ndërtesat e kaltërta". Pas "ndërtesave së kaltërta", Kuçi është përfshirë edhe në blerjen e "NBI- Suhareka", e cila ndodhet në qendër të qytetit të Suharekës. NBI Suhareka është privatizuar nga AKM më 2006 dhe

¹² Organi Shqyrtues i Prokurimit. Vendim 245/2011. Data:21.09.2011. Burimi: http://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2011/ndertim_shtepise_pleqe_shtat11.pdf

¹³ Zyra e Auditorit të Përgjithshëm. Raporti i Auditimit Financiar për Komunën e Suharekës. 2011. Fq-16 & 17. Burimi: http://www.oag-rks.org/repository/docs/Suhareka_31_12_2011_Final_alb_631440.pdf

¹⁴ Zyra e Auditorit të Përgjithshëm. Raporti i Auditimit Financiar për Komunën e Suharekës. 2011. Fq-16 & 17. Burimi: http://www.oag-rks.org/repository/docs/Suhareka_31_12_2011_Final_alb_631440.pdf

¹⁵ Agjencia Kundër Korrupsionit. Deklarimi i pasurisë. Viti 2012. Komuna e Suharekës. Blerim Kuçi.

Burimi: [http://akk-ks.org/2012/Komunat/Komuna_e_Therandes_\(Suharekes\)/Blerim_Kuqi.pdf](http://akk-ks.org/2012/Komunat/Komuna_e_Therandes_(Suharekes)/Blerim_Kuqi.pdf)

¹⁶ Kuvendi i Kosovës. Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit. Neni 17. Fq 7. Burimi:

http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2007_02-L133_al.pdf

¹⁷ Koha Ditore. Data 28.08.2011. Fq 3. Bukuriye Bajraliu. Pjesë të tekstit në portalin Koha.net. Burimi:

<http://www.koha.net/index.php/repository/docs/repository/karikaturat/function.require-once?page=1,13,67234>

blerësi ka qenë firma italiane QMI. Mirëpo, Blerim Kuçi i kishte dhënë borxh QMI-së 450.000 euro, me kushtin që pas privatizimit të prishet bodrumi dhe tokën ta marr kompania "Hidroterm". Që nga privatizimi, NBI Suhareka është shkatërruar dhe nuk ka asnjë plan për investime. 400 punëtorët e kësaj ndërmarrje tani janë të papunë.¹⁸ Ashtu sikurse me rastin e "ndërtesave të kaltërta", edhe në rastin e NBI Suhareka, Kuçi nuk ka qenë Kryetar komune, mirëpo përfshirja e tij në një marrëveshje privatizimi për prishjen e një ndërmarrjeje të suksesshme shoqërore, për t'i krijuar hapësirë biznesit të tij privat dhe lënies së papunë të 400 punëtorëve, bie në kundërshtim me premtimet e tij për zhvillim ekonomik të Komunës dhe rritjen e punësimit.

6. Administrata e Komunës së Suharekës

Komuna e Suharekës ka gjithsej 194 persona të punësuar në administratën komunale, duke përfshirë të punësuarit në Qendrën për Punë Sociale dhe në institucionet kulturore të qytetit. Ndërsa, së bashku me sektorin e arsimit, ku përfshihen të punësuarit në çerdhen e qytetit, në shkollat fillore dhe ato të mesme si dhe në sektorin e shëndetësisë, numri i të punësuarve në institucionet publike komunale është 1.338 persona.

Lidhur me ditët e pushimit të punonjësve të administratës gjatë festave, Komuna e Suharekës në disa raste ka shpërfillur vendimet e nivelit qendror. Për festën e 1 majit, Ditës Ndërkombëtare të Punëtorëve, ditë pushimi ishte shpallur e marta (1 maj), por komuna e Suharekës nuk ka punuar as të hënën (30 prill), ngase i gjithë stafi i komunës i është përgjigjur organizimit për të shkuar në bregdetin e Shqipërisë.¹⁹

Tabela nr.8: Numri i të punësuarve sipas sektorëve në Komunën e Suharekës

Njësitë	Nr. i të punësuarve
Zyra e Kryetarit	11
Drejtoria e Administratës	46
Drejtoria e Inspektionit	8
Drejtoria për Buxhet dhe Financa	27
Drejtoria për Shërbime publike	22
Zyra për Komunitete	1
Drejtoria për Bujqësi	14
Drejtoria e Urbanizimit	21

¹⁸ Gazeta "Jeta në Kosovë". 13 dhjetor, 2011. Si po rrënohet NBI Suhareka. Burimi: <http://gazetajnk.com/index.php?cid=1,987,862>

¹⁹ Gazeta 'Jeta në Kosovë'. 2 maj 2012. Qazim Hasanaj. Burimi: <http://www.gazetajnk.com/?cid=1,1018,2047>

Drejtoria e Shëndetësisë	7
Drejtoria e Arsimit	10
Drejtoria për Kulturë dhe institucionet varesë të saj	14
Qendra për Punë Sociale	13
Gjithsej	194

Nga gjithsej 194 persona të punësuar në administratën komunale, vetëm 32 të punësuar apo 16% janë femra. Nga nëntë Drejtori sa ka Komuna e Suharekës, asnjë prej tyre nuk udhëhiqet nga femrat. Numri i femrave të punësuar është i vogël edhe në sektorin e arsimit të kësaj Komune. Nga gjithsej 992 persona të punësuar në sektorin e arsimit të mesëm dhe fillor në Komunën e Suharekës, duke përfshirë edhe pozitat e mësimdhënësve dhe pozitat e stafit ndihmës, 355 janë femra, ndërsa 637 meshkuj.

7. Arsimi në Komunën e Suharekës

Komuna e Suharekës ka 42 shkolla fillore, një çerdhe publike për fëmijë si dhe dy shkolla të mesme. Në rezultatet zyrtare të testit të maturës për vitin 2011, nga gjithsejtë 724 maturantë të dy shkollave të mesme të komunës së Suharekës që iu kanë nënshtruar testit, 295 prej tyre nuk kanë arritur të kalojnë në afatin e parë.²⁰

Tabela nr.9: Numri i mësimdhënësve dhe stafit përcjellës në 42 shkollat fillore dhe dy shkolla të mesme të Suharekës:

Gjinia	Shkolla fillore		Shkolla të mesme	
	Mësimdhënës	Stafi ndihmës	Mësimdhënës	Stafi ndihmës
Femra	285	8	58	4
Meshkuj	382	129	103	23
Gjithsejtë	667	137	161	27

²⁰ Komuna e Suharekës. Drejtoria e Arsimit. Rezultatet e testit të maturës për vitin 2011. Burimi: <http://kk.rks-gov.net/suhareke/getattachment/Municipality/Departments/Arsim/Raporti/raporti-rreth-rezultateve-te-matures.pdf.aspx>

Tabela nr.10: Numri total i mësimdhënësve, nxënësve dhe stafit ndihmës në 42 shkolla fillore dhe dy shkolla të mesme në Komunën e Suharekës

Kategoria	Numri	F	M
Mësimdhënës	828	343	485
Nxënës	14.558	6.915	7.643
Stafi ndihmës	164	12	152

Investimet në infrastrukturën e shkollave të Suharekës kanë qenë të pakta dhe ato kryesisht janë fokusuar në riparimin e kulmeve, riparimin dhe transformimin e sistemit të ngrohjes, renovime të brendshme të shkollave, ndërrimin e dyerve dhe dritareve dhe gëlqerosje të objekteve. Ndërtim të shkollave të reja nuk ka pasur. Gjatë periudhës 2010-2012 nuk është hasur ndonjë investim i madh në Komunën e Suharekës nga ana e Qeverisë së Kosovës, përkatësisht Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

Tabela nr.11: Disa nga investimet ne shkollat e Suharekës gjatë periudhës 2010 -2012

Investimet	Shuma
Ndërtimi i sallës për aktivitete sportive në shkollën "Shkëndija"	129,638
Ndërtimi i rrethojës së oborrit në shkollën fillore "Dëshmoret e Tivarit"	20.731.
Rregullimi i oborrit të shkollës së mesme teknike "Skënder Luarasi"	2.500
Riparimi i ngrohtores për shkollën fillore "Lidhja e Prizrenit"	1.661
Rregullime të jashtme për shkollën "Destan Bajraktari"	1.996
Renovimi i kulmit në shkollën fillore "17 shkurti" në Shirok	7.901
Instalimi i njejeve sanitare në shkollën fillore "Skënderbeu"	3.503
Rregullime të jashtme për shkollën fillore "Besim Ndrecaj"	8.643
Rregullimi i ngrohjes të shkollës së mesme teknike "Skënder Luarasi"	1.487
Instalimi i trafos elektrike për shkollën fillore "Destan Bajraktari"	1.840
Instalimi i njejeve sanitare për shkollën fillore "Kongresi i Manastirit"	9.447
Blerja e dyerve, dritareve, bankave, karrigeve për shkollat e Suharekës	24.843
Rregullimi i rrethojave të shkollave fillore në fshatrat Leshan dhe Shirok	9.496
Rregullimi i dyshemesë për shkollën fillore "7 marsi"	4.887
Renovimi i brendshëm i shkollës "Ram Bllaca"	6.990

8. Transparenca

Zyra për Informim në Komunën e Suharekës funksionon brenda Zyrës së Kryetarit dhe ka vetëm një person të punësuar. Kjo Komunë mbulohet rrallë nga mediumet e shkruara dhe ato elektronike. Asnjë medium i nivelit qendror nuk ka korrespondent nga ky lokalitet. Mediumet qendrore kohë pas kohe i mbulojnë zhvillimet nga Komuna e Suharekës, por që ato paraqitje nuk përkojnë me problemet që ndërlidhen me qeverisjen lokale.

Mediat e shkruara nacionale nuk kanë korrespondent nga kjo komunë. Korrespondentët e angazhuar për Komunën e Prizrenit obligohen të raportojnë edhe për zhvillimet në Komunën e Suharekës.

Komuna e Suharekës është njëra ndër komunat ku më së paku gjen të dhëna, informata dhe dokumente në faqen e saj zyrtare. Në këtë faqe nuk mund të gesh asnjë raport për buxhetin apo për mënyrën dhe fushat e shpenzimit të parasë publike. Shkalla e informatave në fushat e tjera janë të pakta dhe ato që mund të hasen janë gjysmake dhe të vjetruara në kohë. Nuk publikohen as procesverbalet nga mbledhjet e Kuvendit Komunal apo të shpalljeve (dokumenteve) të tjera më rendësi për opinionin. Gjitha këto e kategorizojnë Komunën e Suharekës në mesin e komunave me pak transparente në vend.

Tabela: nr.12: Vlerësim i përmbajtjes së faqes së Komunës së Suharekës-
<http://kk.rks-gov.net/suhareke/Home.aspx>

Dokumenti	2010				2011				2012			
	I	II	III	IV	I	II	III	IV	I	II	III	IV
Raporti i Punës së Kryetarit	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Raporti financiar i Komunës	x	x	x	x	x	x	x	√	x	x	x	x
Raportet e Drejtorisë për Administratë dhe Inspektion	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Raportet e Drejtorisë së Arsimit	x	x	√	x	x	√	x	x	x	x	x	x
Raportet e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Drejtoria për Financa dhe Zhvillim Ekonomik	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencia	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Drejtoria e Urbanizimit, Pronës, Kadaster dhe Ambient	x	x	x	√	x	x	x	√	x	x	x	x
Drejtoria e Mërgatës	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	x	x	x	√	x	x	x	√	x	x	x	x
Zyra e Prokurimit	√				√				√			
Raportet e Njësisë së Auditimit të Brendshëm	x				x				x			
Procesverbalet e Kuvendit Komunal	x				x				x			
Rregulloret Komunale	√				√				√			
Vendimet e Kuvendit Komunal	√				√				√			
Rregullorja e Punës së Kuvendit					√							
Planet dhe Strategjitë e Komunës					√							

X = mungon raporti.

√ = raporti është i publikuar në ueb-faqe.

9. Përbushja e premtimeve të fushatës zgjedhore 2009

Gjatë fushatës zgjedhore 2009 kandidati për kryetar komune, tani Kryetari i Komunës z. Blerim Kuçi, para elektoratit të tij ka shpalosur premtime në sfera të ndryshme. Pas monitorimit të të gjitha premtimeve të dala nga fushata zgjedhore, Instituti GAP dhe BIRN, në maj të vitit 2010 i kanë shkruar letër të hapur Kryetarit të Komunës të cilit ia përkujtuan edhe një herë premtimet e dhëna, duke kërkuar njëkohësisht realizimin e tyre.

Tabela e mëposhtme vlerëson progresin e arritur në realizimin e premtimeve të dhëna në vitin 2009. Në këtë tabelë janë përfshirë 18 premtime të dhëna. Në bazë të hulumtimit të GAP del se pas tri viteve të qeverisjes në Komunën e Suharekës, 11 premtime janë përbushur, 4 tjera nuk janë përbushur, ndërsa në 3 premtime ka pasur nisma dhe rezultate evidente, por nuk mund të konsiderohen akoma premtime të përbushura.

Premtimet e 2009	Realizimi 2010-2012
Për fshatin Budakovë, sigurimin e ujit të pijes, përkatësisht shpërndarjen e rrjetit të ujësjellësit, ndërtimin e objektit të Zyrës së Gjendjes Civile, Shtëpisë së Kulturës dhe çerdhes së fëmijëve	Në këtë fshat ka përfunduar në dy faza rregullimi dhe asfaltimi i rrugëve lokale, ndërsa objektet dhe investimet tjera të premtuara nga Kryetari aktual i komunës asnjëra nuk janë nisur dhe as që ka pasur ndonjë plan në këtë drejtim. Ky premtim vlerësohet i pa përbushur.
Për fshatin Leshan, ndërtimin e rrugës Leshan i vogël relacioni për Shirokë, ndërtimin e objektit të ri shkollorë, rregullimin e rrjetit të ujësjellësit, deponi për grumbullimin dhe menaxhimin e mbeturinave dhe stimulimin për pesë bujqit më të suksesshëm të Leshanit	Ndërtimi i rrugës dhe i ujësjellësit ka përfunduar. Për objektin e shkollës dhe për deponinë e mbeturinave nuk ka pasur ndonjë nismë konkrete nga Komuna, po ashtu nuk ka ndonjë të dhënë që tregon se Komuna e Suharekës ka veçuar bujqit më të suksesshëm. Ky premtim vlerësohet pjesërisht i përbushur.
Për fshatin Stravucinë, rregullimin e ujësjellësit, asfaltimin e rrugëve nëpër fshat, ndërtimin e rrugës së re Stravucinë-Mohlan dhe urbanizimin e fshatit.	Nga gjitha këto vetëm rruga në drejtimin Stravucinë-Mohlan edhe atë pjesërisht. Projektet e tjera nuk janë bërë. Ky premtim vlerësohet i pa përbushur.

Për fshatin Nishor, rregullimin e kanalizimit, investime në sigurimin e ujit të pijshëm, rregullimin e rrethojës së shkollës	Këto projekte janë përbushur, me përjashtim që rrjeti i ujësjellësit është instaluar në disa zona, jo në të gjitha dhe mungesa e ujit të pijes është e theksuar. Ky premtim vlerësohet i përbushur.
Për fshatin Studencan, meremetimin e shkollës, rregullimin e rrjetit të ujësjellësit, kanalizimin, ndërtimin e infrastrukturës rrugore, dhe investime në mbrojtjen e ambientit	Këto përgjithësisht vlerësohen të përbushura për fshatin Studencan. Premtim i përbushur.
Për fshatin Bllacë, ndërtimin e Shtëpisë së Kulturës, ndriçimin publik, funksionalizimin e rrjetit të ujësjellësit, përkrahjen e 10 familjeve që merren me bujqësi	Në fshatin Bllacë është ndërtuar një objekt i QMF, po ashtu kanë përfunduar rregullimi dhe asfaltimi i rrugëve lokale dhe është rritur kapaciteti i ujit të pijes si dhe kanalizimi i fshatit. Nuk është bërë Shtëpia e Kulturës si dhe përkrahja ndaj bujqve ka qenë e përgjithshme, jo e veçantë për ndonjë fshat apo individ. Ky premtim mund të vlerësohet i përbushur.
Ndërtimin e rrugës Kroj i Madh-Kravasari dhe rrugës Kroj i Madh-Bellanicë	Këto rrugë janë ndërtuar gjatë vitit 2012. Premtim i përbushur.
Ndërtimin e rrugëve Budakovë-Dardhishtë e Epërme, lagja e Palushëve-lagja Hoxha si dhe lagja Buzhala.	Rruga Budakovë - Dardhishtë nuk është asfaltuar, por është rregulluar me zhavorr. Ndërsa asfaltimi i rrugëve në lagjet e cekura ka përfunduar. Premtim i përbushur.
Ndërtimin e shtëpisë së kulturës	Nuk ka pasur ndonjë ndërtim të ri të ndonjë Shtëpisë së Kulturës. Komuna e Suharekës edhe me herët ka pasur Shtëpinë e Kulturës "Ukë Bytyqi". Gjatë tri viteve të fundit ka pasur disa investime sipërfaqësore në riparimin e kësaj shtëpie.
Ndërtimin e çerdhes së fëmijëve	Komuna e Suharekës ka një çerdhe publike dhe dy çerdhe të ndërtuara në partneritet publiko - privat. Ndërtimi i çerdheve në partneritet mund të vlerësohet si premtim i përbushur.
Bursa për 100 studentë nga komuna e Suharekës	Studentët dhe nxënësit në Suharekë kanë mbështetjen më të madhe me bursa në krahasim me studentët dhe nxënësit në

	<p>Komunat tjera.</p> <p>Për çdo vit, Komuna i ndanë 60 bursa për 40 studentë dhe 20 për nxënësit më të suksesshëm.</p> <p>Përveç kësaj, studentët përfitojnë bursa edhe nga fondacioni "Hajdin Berisha", fondacion i krijuar në 2002 nga vetë Blerim Kuçi dhe kompania e tij "Hidroterm". Studentët përfitues të kësaj burse marrin bursë nga 50-100 euro (në muaj), për 3-4 vitet e shkollimit të tyre. Blerim Kuçi ndan pagën e tij të kryetarit për bursat e studentëve. Këtë shembull e kanë ndjekur edhe nënkryetari i komunës Refki Bytyçi, dhe dy anëtarët e KK, Shefket Kuçi dhe Lulzim Berisha. Premtim i përmbushur.</p>
Më shumë investime për banorët e fshatit Novoselës e Ulët	Nuk ka pasur rritje të investime për këtë fshat, përjashtimisht rregullimit të dy rrugëve lokale. Premtim pjesërisht i përmbushur.
Përkrahje për ndërmarrjet prodhuese të cilat sjellin zhvillim ekonomik dhe vende të reja pune. Prodhuesit s' do të paguajnë taksa	Nuk ka të dhëna nëse Komuna ka ndërmarr ndonjë vendim të kësaj natyre. Premtim i pa përmbushur.
Formimin e Drejtorisë për Diasporë	Premtim i përmbushur. Komuna e ka formuar Drejtorinë e Mërgatës.
Përkrahje për bujqësinë; do të krijohet agjencioni për përkrahje të agrobiznesit, hartim programesh, fizibilitete, dhe përpilimin e kërkesave në fondet për bujqësi, etj. 120 bujq do të stimulohen nga agjencioni (qoftë përmes granteve apo kredive), do të sigurohen karburantet, farat etj.	Premtim i përmbushur. Bujqit në përgjithësi kanë gëzuar përkrahjen e Komunës dhe përkrahja e tyre është bërë edhe nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR) si dhe nga donatoret e ndryshëm. Në tri vitet e fundit është vërejtur një forcim dhe interesim me i madh i banorëve të Komunës së Suharekës për të investuar në sektorin e bujqësisë dhe atë të blegtorisë.
Sigurimin e ujit të pijshëm, përmes planit strategjik që ka hartuar AAK-ja (ndërtimin e rezervuarëve kryesorë, rregullimin	Në tri vitet e fundit llogariten më se 20 puse të hapura në Komunën e Suharekës dhe një i tillë është hapur edhe në oborrin

dhe ndërtimin e rrjetit kryesor, pompave dhe puseve)	e Komunës si dhe në QKMF. Investimet tjera në rrjetin e ujësjellësit kanë qenë solide. Premtim i përmbushur.
Rregullimin e rrugës dytësore (për shkarkimin e rrugës kryesore Prishtinë - Prizren, si dhe rregullimin e rrugën Duhël - Suharekë.	Nuk janë bërë asnjë nga këto. Premtim i pa përmbushur.
Ndërtimin e unazës në vreshtarinë në Biraqen si dhe vendosja e shenjave të komunikacionit.	Shenjat e komunikacionit janë vendosur përgjithësisht, dhe për çdo vit Komuna ka pasur kompani të përzgjedhur për vendosjen dhe mirëmbajtjen e tyre. Unaza në vreshtarinë në Biraqen nuk ka nisur dhe as që ka pasur plane komunale në këtë drejtim. Premtim pjesërisht i përmbushur.

10. Burimet

1. Komuna e Suharekës. Drejtoria për Buxhet dhe Financa. Raporti Financiar, janar dhjetor -2011. Burimi: <http://kk.rks-gov.net/suhareke/Municipality/Assembly/Reports.aspx>
2. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Rezultatet e zgjedhjeve për Kryetar të Komunave. 2009. Burimi: <http://www.kqz-ks.org/SKQZ-WEB/al/zgjedhjetekosoves/materiale/rezultatet2009/kryetar/results%20by%20municipality%20.pdf>
3. Agjencia e Statistikave të Kosovës. Rezultatet përfundimtare për Regjistrimin e Popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave - 2011. Burimi: http://esk.rks-gov.net/rekos2011/repository/docs/Te%20dhenat%20kryesore_ALB.pdf
4. Kuvendi i Kosovës. Ligji për Financat e Pushtetit Lokal. Burimi: http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2008_03-L049_al.pdf
5. Instituti për Studime të Avancuara GAP. Të dhënat e Regjistrimit të Popullsisë dhe ndikimi i tyre në Politikat Publike. Burimi: http://www.institutigap.org/documents/67092_GAPanalizepertedhenateASK.pdf.
6. Komuna e Suharekës. Profili i Suharekës. Burimi: <http://kk.rks-gov.net/suhareke/getattachment/Home/Profili-i-Komunes.pdf.aspx>
7. Organi Shqyrtues i Prokurimit. Vendimet e shpallura. Komuna e Suharekës. Viti 2010. 2011. 2012. Burimi: <http://oshp.rks-gov.net/?cid=1,71>
8. Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik. Njoftimet e shpallura. Komuna e Suharekës. 2011. Burimi: <https://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=Notices&LID=1&PCID=-1&CtlID=ViewNotices&ID=50947>
9. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm. Raporti i Auditimit Financiar për Komunën e Suharekës. 2011. Burimi: http://www.oag-rks.org/repository/docs/Suhareka_31_12_2011_Final_alb_631440.pdf
10. Agjencia Kundër Korrupsionit. Deklarimi i pasurisë. Viti 2012. Komuna e Suharekës. Blerim Kuçi. Burimi: [http://akk-ks.org/2012/Komunat/Komuna_e_Therandes_\(Suharekes\)/Blerim_Kuçi.pdf](http://akk-ks.org/2012/Komunat/Komuna_e_Therandes_(Suharekes)/Blerim_Kuçi.pdf)
11. Kuvendi i Kosovës. Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit. Neni 17. Burimi: http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2007_02-L133_al.pdf
12. Tabelat e Buxhetit të Qeverisë së Kosovës për vitin 2011. <http://mf.rks-gov.net/sqal/ministriaefinancave/buxhetiirepublikessekosoves/buxhetiqendrore.aspx>
13. Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë. Statistikat e Arsimit në Kosovë 2011. Burimi: <http://www.masht-gov.net/advCms/documents/11052012.pdf>
14. Faqja Zyrtare e Komunës së Suharekës. Burimi: <http://kk.rks-gov.net/suhareke/Home.aspx>
15. Komuna e Suharekës. Drejtoria e Administratës. Lista e të punësuarave në Komunën e Suharekës.
16. Komuna e Suharekës. Drejtoria për Buxhet dhe Financa. Raporti Financiar, janar - dhjetor 2012.
17. Komuna e Suharekës. Drejtoria e Shëndetësisë. Lista e të punësuarave në sektorin e shëndetësisë në Komunën e Suharekës.